



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Permet, më 12-10-2018

TERMAT E REFERENCËS

Objekti: Financier Part-Time

Projekti: “Dhuro Dashuri”

Përshkrimi i projektit:

Projekti “Dhuro Dashuri” implementohet nga shoqata “Solidariteti Tani” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD, ky projekt fiancohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP. Projekti “Dhuro Dashuri” ka si qëllim rritjen e përfshirjes sociale të grupeve në nevojë siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara. Projekti synon që këta fëmijë të ndihen si të gjithë fëmijët e tjerë duke i mbështetur, ofruar shërbime sociale, shërbime psiko-edukative etj, për integrimin dhe promovimin e vlerave të tyre.

“Solidaritet Tani” është një organizatë jo-fitimprurëse e cila angazhohet në mbrojtjen dhe ndihmën për fëmijët me aftësi të kufizuara në rrethin e Permetit dhe më gjerë.

Përshkrimi i shërbimit që kërkohet:

“Solidaritet Tani” në kuadër të projektit “Dhuro Dashuri”, është e interesuar të kontraktojë një financier për mbajtjen dhe plotësimin e të gjitha shënimeve dhe dokumentave financiare gjatë implementimit të projektit.

Shërbimi i kërkuar përfshin plotësimin e dokumentave të ndryshëm financiarë, raporteve, shënimeve të buxhetit dhe çdo aspekt tjetër i karakterit financiar i cili lidhet me zbatimin e projektit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE KERKUARA

	Kërkohet
Arsimi:	I lartë. Ekonomist
Njohuri Kompjuterike:	Njohuri të mira për programet word, excel, pasqyra financiare.
Kapaciteti:	Eksperiencë e mëparshme në zbatim projektësh, funksioni financiar. Ose të ketë punuar si economist/financier ne sector privat ose publik. Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Dokumentacioni i detyrueshëm

1. Fotokopje e diplomës universitare apo diplomave/certifikimeve të tjera nëse ka
2. CV e plotë e personit duke përfshirë edhe përshkrimin e detyrave për çdo punë të mëparshme që ka kryer
3. Të paktën një reference (duke përfshirë edhe kontaktet) nga një punëdhënës i mëparshëm.

Vlerësimi i aplikimeve do të mbështetet duke pasur përmbushjen e kritereve të kërkuara

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën **me poste**, duke shkruar mbi zarfin e mbylluar **“Financier part-time, shoqata Solidariteti Tani”** pranë zyrës të shoqatës sonë deri më datë 22/10/2018, ora 13:00
Aplikimet mund të dorëzohen edhe me email në solidaritetitani@hotmail.com

Adresa:

Shoqata “Solidariteti Tani”, Rruga “Kongresi i Përmetit”, Lagjia e Re, Përmet, Shqipëri. -
solidaritetitani@hotmail.com

Aplikimet Dorazi nuk pranohen

Preferojmë kandidat me vendbanim Bashkia Përmet.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).